2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Ne përfundim afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Ne përfundim afatave të ankimit)

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.** (Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE):  
\_\_\_\_\_ **Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të pa ofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>  | <i>3</i>                 | <i>4</i>   | <i>5</i>                            | <i>6</i>  |
|---|---|--------------------------|--|-------------------------------------|---|
| <b>A<br/>rt<br/>i</b>                     | <b>Përshkrimi i shërbimit</b>                                       | <b>Njesia<br/>(muaj)</b> | <b>Sasia</b>   | <b>çmimi<br/>për njësi<br/>leke</b> | <b>Çmimi total<br/>për shërbimin<br/>(leke)</b> |
| 1.  | Shërbim Ruajtje me roje 24 orë (Turn I+II+III)                      | 48 muaj                  | 5 vend/roje x 4.98 =<br><b>24.90 roje</b>                        |                                     |   |
| 2.  | Shërbim Ruajtje me roje Turni pare (8 dhe 12 orë)                   | 48 muaj                  | 2 x 1.78 roje/ved<br>1 x 1.42 roje/ved =<br><b>4.98 roje</b>     |                                     |   |
| 3.  | Shërbim ruajtje me sistem alarm dhe kamera vëzhgimi non stop 24 ore | 48 muaj                  | <b>1</b> sistem alami,<br><b>8</b> sistem kamera vëzhgimi 24 ore |                                     |   |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |   |                          |  |                                     |   |
| <b>TVSH (%)</b>                           |   |                          |  |                                     |   |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |   |                          |  |                                     |   |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |   |                          |  |                                     |   |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |   |                          |  |                                     |   |
| <b>Vula</b>                               |   |                          |  |                                     |   |
| <b>Datë</b> _____                         |   |                          |  |                                     |   |

---

## Sqarime

1. Ne çmim te perfshihen te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes per vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe nje vend-roje me një dhe tre turne në muaj.

| Nr. | Emërtimi  |
|-----|---|
| 1   | Shpenzime për pagë bazë                                 |
| 2   | Shtesë mbi pagë për turnin II                           |
| 3   | Shtesë mbi pagë për turnin III                          |
| 4   | Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7% |

### Analiza e kostos

- Operoret janë të detyruar të paraqesin analizën e detajuar me menyren e perlllogaritjes se koston për ofertën e paraqitur si dhe preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha koston per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr.113 date 1.3.2023 "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zevendesimit **1.66** për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen
- Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.



---

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

#### “Shërbimi Kerkohet te kryhet: Me punonjes sherbimi dhe sisteme elektronik”

-Shërbimi i sigurise ne Spitalin Rajonal Elbasan, referuar planë-vendosjes dhe shtrirjes se gjere territoriale,

kerkohet te kryhet ne 8(tete) vendroje. Ne godinat spitalore sherbimi kerkohet i kombinuar, sherbim me

punonjes sherbimi fikse ne ambientet hyrese/pritesa te pacienteve 24 ore, 12 dhe 8 ore si dhe sherbim ruajtje sistem/vezhgim sinjalizimi. **Sipas tabelës**

| <b>N r</b> | <b>Emertimi i Objektit ku do te kryhet sherbim</b> | <b>Nr. V/dr oje</b> | <b>Turne dhe Ore sherbimi</b>  | <b>Nr. i rojeve vendro je</b> | <b>Sist alarm</b> | <b>Kamera Vezhgimi 24 ore</b> |
|------------|--|---------------------|--------------------------------|-------------------------------|-------------------|-------------------------------|
| 1          | Spitali (Pathollogji)                              | 1                   | 3 turne, 24 ore                | 4.98                          |                   | 5(pese) kamera vezhgimi       |
| 2          | Spitali (Kirurgji+Maternitet +pavjoni i mjekimit)  | 1                   | 3 turne, 24 ore                | 4.98                          |                   | 5(pese) kamera vezhgimi       |
| 3          | Spitali (Urgjenca+Neurologji)                      | 1                   | 3 turne, 24 ore                | 4.98                          |                   | 5(pese) kamera vezhgimi       |
| 4          | Spitali (Pediatria)                                | 1                   | 3 turne, 24 ore                | 4.98                          |                   | 5(pese) kamera vezhgimi       |
| 5          | Poliklinika Specialiteteve                         | 1                   | 3 turne, 24 ore                | 4.98                          |                   | 6(gjashte) kam.vezhgimi       |
| 6          | Godina (Telemjekesia)                              | 1                   | 1.5 turn, 12 ore (hene-premte) | 1.78                          |                   | 4(kater) kamera vezhgim       |
| 7          | Godina Administrates (Drejtoria)                   | 1                   | 1.5 turn, 12 ore (hene-premte) | 1.78                          | 1 sist alarm      | 3(tre) kamera vezhgimi        |
| 8          | Pavjoni i trajtimit me metadon varetseve           | 1                   | 1 turn, 8 ore                  | 1.42                          |                   | 2 (dy) kamera vezhgimi        |

|          |  |               |  |  |  |
|----------|--|---------------|--|--|--|
| narkotik |  | (hene-shtune) |  |  |  |
|----------|--|---------------|--|--|--|

### Sherbimi kerkohet te jete:

- Ne bllokun spitalor, 4 spitalet (Pathollogji, Urgjenca+Nerologji, Pediatria dhe Kirurgji+ Maternitet) kerkohet sherbim sigurie me punonjes sherbimi me tre turne 24 ore nga e hene ne te diel, per mbajtjen e rregullit dhe te qetesise te pacienteve dhe shoqeseve te tyre, meqellim respektimin e regjimit te sherbimeve spitalore te afishuara nga drejtoria. Gjithashtu referuar rasteve problematike te hasura nga pacientet dhe shoqesit e tyre, sherbimi i sigurise do te mbulohet me masa shtese me sistem vezhgimi elektronike, te ambjenteve hyrese-dalese dhe pritesa pacienteve, kjo ne zbatim te kerkesave te ligjit Nr.19/2016 date.10.03.2016 dhe Udhezimit te Ministrit Brendshem Nr.633 date 6.11.2018 "Per percaktimin e masave shtese te sigurise publike" si dhe njoftimit te policise dhe Prokurorise per kete qellim.
- Godina Poliklinika e Specialiteteve rikonstruktuar totalisht, me pajisje dhe aparatura mjeksore te reja, me vendndodhje qyteti Elbasan me shtrirje territoriale 2000 m2, e hapur ne te gjitha anet me dritare pa zgara mbrojtese, te rriskuar ndaj vjedhjeve/grabitjeve te aparaturave, sherbimi i sigurise kerkohet i kombinuar me roje me tre turne dhe masa shtese kamera vezhgimi.
- Ne godinen (telemjeksia dhe godina Administrates/drejtoria) referuar sherbimeve te imazheris (rezonanca, ego, grafi e skopive) si dhe godina e administrates sherbimi i sigurise kerkohet i kombinuar me roje turni pare 1.5 turn (12 ore e hene-premte) dhe pjesa tjeter me sistem elektronik.
- Ne pavjonin e trajtimit te semureve te ish dhe te varesise ndaj lendeve narkotike, qe trajtohen me (metadon) nepermjet paraqitjes fizike te ketyre personave per ta pire ne prezenc te mjekut perkates dhe punonjesit te policise kundrejte nenshkrimit ne regjistrat perkates me dokument identifikimi. Referuar statistikave personat qe trajtohen me kete medikament ne vartesi te gjendjes qe percokton mjeku çdo dite ose njere ne dy dite te personave te ndryshem, per keto arsye, eshte e nevojshme mbajtja nen kontroll gjate konsumimit, ku nga ana jone eshte gjykuar e nevojshme nje sherbim me nje punonjes turni pare.

### Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise kerkohet te kryhet per spitalet sipas vendndodhjes ne tabelen sipercituar me punonjes sherbimi dhe masa shtese sigurie sistem/vezhgim sinjalizimi, shoqeria te marre persiper ruajtjen, parandalimin e vjedhjeve, demtimeve te materialeve.
2. Sherbimi te kryhet ne zbatim ne Ligjet 75/2014, 74/2014 si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniforme, paisje nderlidhje dhe mjet transporti. Sherbimi ne objekte te behet me plan disllokimi dhe skemen e ruajtjes se objekteve sipas shtrirjes se tyre. Ne cdo vedsherbim te kete liber sherbimi per marrjen dhe dorezimin e detyres me instruktazhin e nevojshem nga pergjegjesi i sherbimit/Drejtuesi Teknik i Shoqerise.
3. Punonjesit e sherbimit te jene te çertifikuar konforme Ligjit 75/2014, gjate ushtrimit detyres punonjesi te jete i pajisur me uniformen, shenjen dalluese, emblemen, stemen e shoqerise, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhes, rrip multifunksional, konform Udhezimit te MB nr.130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e ShpsP".
4. Të ketë qendër kontrolli me 5(pesë) operator dhe grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me 2 (dy) punonjës për çdo turn për drejtimin, mbikqyerjen dhe menaxhimin e shërbimeve per verifikimin e sinjaleve te alarmit dhe menaxhimin e sherbimeve. Grupi i sherbimit te jete i pajisur me uniform, armatim me autorizimin e perdorimit arme, nderlidhje, automjete me stemen e shoqerise si dhe pajisje te tjera speciale per nderhyrje ne raste te ngjarjeve.
5. Çdo vendsherbim te jete i pajisur me: - Nje radio-komunikimi dore, hekura lidhes, shkop gome si dhe pajime te tjera te cilet perdoren nga cdo punonjes sherbimi sipas turnit perkates.
6. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve , sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve , shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera te njohura me ligj.
7. Kontraktori mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne objekte qe ruhet nga ana e

---

tij, kur keto vijne si rezultat i moskryerjes me korektesi te sherbimit apo mungeses se vigjilences te rojeve, dhe qe vertetohet nga organet kompetente. Ne kete rast kontraktori detyrohet te beje çdemtimin 100% te vleres se demtuar.

**Detyrat e punonjesit sherbimit:**

1. Të mbaje dhe te perdore ne rregull uniformen, pajimet, simbolet, shenjat dalluese dhe dokumentin e identifikimit si punonjes sherbimi.
2. Të komunikojë me etikë, sjellja qytetare me vizitoret, personelin dhe çdo autoritet ligjzbatuese.
3. Të marre ne dorezim sherbimin nga turni i meparshem pasi ka kontrolluar objektet dhe konstaton cdo gje ne rregull duke firmosur librin e marrjes ne dorezim sherbimit dhe ne perfundim te sherbimit firmos dorezimin e detyres.
4. Të zbatoje rregulloren e brendshme te institucionit, te vendos rregull e qetesesi ne objekt, te jete vigjilent i perkushtuar, te mos perdore pije alkolike ne sherbim, te bashkepunoje dhe te ndihmoj personelin kur i kerkoet.
5. Të informoje **sallen operative te policise (129)** kur eshte rasti i ndonje ngjare vepre penale ne objekt si (Grabitje/vjedhje, zjarre) **Drejtuesit e Institucionit dhe drejtuesin teknik e titullarin e SHPSF-se.**

**Afatet e ekzekutimit:** 48 muaj ( i parashikuar)

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

**“Shërbimi i ruajtjes me punonjes shërbimi dhe sistem/vezhgim sinjalizimi i Spitalit Rajonal Elbasan - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj**

**Sherbimit:**

| Numri i Vendrojeve                                 | Numri i turneve   | Numri i rojeve te nevojshme                        | Afati i levrimnit   |
|--|---|--|---|
| 5 (pese)   | Shërbim Ruajtje me roje 24 orë (Turn I+II+III)                      | 5 vend/roje x 4.98 = 24.90 roje                    | <i>Kontratata do te nenshkruhen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj.</i>  |
| 3 (tre)  | Shërbim Ruajtje me roje Turni pare (8 dhe 12 orë)                   | 2 x 1.78 roje/ved<br>1 x 1.42 roje/ved = 4.98 roje | <i>Kontratata do te nenshkruhen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj.</i>  |
| 1 sistem alami,<br>8 sistem kamera vëzhgimi 24 ore | Sherbim ruajtje me sistem alarm dhe kamera vëzhgimi non stop 24 ore | 1 sistem alami,<br>8 sistem kamera vëzhgimi 24 ore | <i>Kontratata do te nenshkruhen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj..</i> |

**Kjo marreveshje Kuader dhe cdo minikontrate e lidhur me subjektin privat te sherbimit te sigurise do te konsiderohet e zgjidhur nese Shoqeria “ILLYRIAN GUARD” SHA shpreh mundesine e ofrimit te sherbimit te sigurise, sipas kushteve te AK**

---

**Afatet e ekzekutimit: 48 muaj.**

## **Shtojca 7**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

**“Shërbimi i ruajtjes me punonjes shërbimi dhe sistem/vezhgim sinjalizimi i Spitalit Rajonal Elbasan - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 48 muaj**

**Detyrat: Parandalimi, bllokimi, bashkepunimi me autoritetet e policise se rendit ne rastet e mundshme te vjedhjeve, demtimeve e shkaterrimeve te objekteve, prones dhe te pasurise se Spitalit Rajonal Elbasan, per zbulimin dhe kapjen e autoreve.**

#### **Shpërndarja:**

**Sipas vendndodhjes objekteve/godinave spitalore sipas (shtojca 5)**

#### **Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

- Ne bllokun spitalor, 4 spitalet (Pathologji, Urgjenca+Nerologji, Pediatria dhe Kirurgji+ Maternitet) kerkohet shërbim sigurie me punonjes shërbimi me tre turne 24 ore nga e hene ne te diel, per mbajtjen e rregullit dhe te qetesise te pacienteve dhe shoqesive te tyre, meqellim respektimin e regjimit te shërbimeve spitalore te afishuara nga drejtoria. Gjithashtu referuar rasteve problematike te hasura nga pacientet dhe shoqesit e tyre, shërbimi i sigurise do te mbulohet me masa shtese me sistem vëzhgimi elektronike, te ambjenteteve hyrese-dalese dhe pritese pacienteve, kjo ne zbatim te kerkesave te ligjit Nr.19/2016 date.10.03.2016 dhe Udhezimit te Ministrit Brendshem Nr.633 date 6.11.2018 "Per percaktimin e masave shtese te sigurise publike" si dhe njoftimit te policise dhe Prokurorise per kete qellim.
- Godina Poliklinika e Specialiteteve rikonstrukstruktuar totalisht, me pajisje dhe aparatura mjeksore te reja, me vendndodhje qyteti Elbasan me shtrirje territoriale 2000 m2, e hapur ne te gjitha anet me dritare pa zgara mbrojtese, te rriskuar ndaj vjedhjeve/grabitjeve te aparaturave, shërbimi i sigurise kerkohet i kombinuar me roje me tre turne dhe masa shtese kamera vëzhgimi.
- Ne godinen (telemjeksia dhe godina Administrates/drejtoria) referuar shërbimeve te imazheris (rezonanca, ego, grafi e skopive) si dhe godina e administrates shërbimi i sigurise kerkohet i kombinuar me roje turni pare 1.5 turn (12 ore e hene-premte) dhe pjesa tjeter me sistem elektronik.
- Ne pavjonin e trajtimit te semureve te ish dhe te varesise ndaj lendeve narkotike, qe trajtohen me (metadon) nepermjet paraqitjes fizike te ketyre personave per ta pire ne prezenc te mjekut perkates dhe punonjesit te policise kundrejte nenshkrimin ne regjistrat perkates me dokument identifikimi. Referuar statistikave personat qe trajtohen me kete medikament ne vartesi te gjendjes qe percokton mjeku çdo dite ose njere ne dy dite te personave te ndryshem, per keto arsye, eshte e nevojshme mbajtja nen kontroll gjate konsumimit, ku nga ana jone eshte gjykuar e nevojshme nje shërbim me nje punonjes turni pare.

---

**Afatet e ekzekutimit: 48 muaj.**

## **Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]  
**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e ofertes (shtojca 1,2 dhe Sqarime)*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

- 2.1.1 Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike” e vlefshir miratuar me vendim të DPP se shtetit për nënkategorin 1.3.A, me veprimtari “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;
- 2.1.2 Çertifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;
- 2.1.3 Çertifikatë për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave nënkategoria 1.3.A, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, në bazë të ligjit nr.75/2014, për jo më pak se 30 (tridhjetë);

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021-2022-2023) jo më pak se vlera e perloqaritur e kontratës, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perloqaritur e kontratës”. Bilançet për tre vitet e fundit financiare viti 2021-2022-2023 konforme kërkesave të nenit 41 të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor të pasqyrave financiare" kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilançet e kërkuara në dy vite të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- 2.2.2 Vërtetim nga pushteti vendor (Bashkitë) që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të regjistruara në QKB për vitin 2023. Ndërsa për vitin 2024 për afatin e maturimit të detyrimeve vendore në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Përmbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve. Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

#### 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë të paktën prej 45,000,000 (dyzetë e p milionë) lekë, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
  - a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen e kontratës ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara gjatë tre viteve të fundit.
  - b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- 2.3.2 Operatori ofertues duhet të paraqesë Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në RSh” me zonë mbulimi ku të përfshihet objekti i prokurimit.
- 2.3.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan konform Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë.
- 2.3.4 Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan,

---

lëshuar pas datës 15 maj 2024, në të cilën të pasqyrohet informacioni: -Objekte në ruajtje me punonjese të certifikuar për jo më pak se 30(tridhjetë) -Të ketë qendër kontrolli me 5(pesë) operator dhe grup të gatshëm 24 orë (tre turne) me 2(dy) punonjës për çdo turn gjithsej 6 (gjashtë); -Të ketë një përgjegjës shërbimi; -Të mosë ketë marrë masë administrative nga policia vendore për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik sipas deklaramit QKB-se për periudhën Janar 2024 e ne vazhdim (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të)

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit që përkojnë sipas legjislacionit tatimor me hapjen e tenderit, të shoqëruar me listëpagesat kontributeve të sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025/a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 30(tridhjetë) punonjës shërbimi të certifikuar nga DVPolicisë Elbasan në kategorinë 1.3.A, të siguruar për çdo muaj si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DT. Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues të disponojë automjete në pronësi apo të marra me qira me kontratë, për ndërhyrje në raste emergjente, jo më pak se 3 (tre) automjete (Autovetur) një në çdo turn të shoqëruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve. Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon në pronësi jo më pak se 8 (tetë) arme zjarri brezi të kategorisë B1. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë:

1. Autorizim për blerje arme zjarri kategorisë B1 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
2. Kontrate shitblerje arme me një shoqëri të licensuar për shitblerje armesh shoqëruar me të dhëna konkrete, numrin serial për secilën armë.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartësisht kategorinë e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.A për Shërbimin Pri të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbim Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.A

**2.3.8** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. **(Shih Shtojca 1, Sqarime)**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikimi.

*Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes, te dorezuara ne menyre elektronike i referohemi nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij*

neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

## Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi  | Përgjigjja |
|---|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----      |
| Numri NIPT/et:  | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar   | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):  | -----      |
| Telefoni:   | -----      |
| E-mail:   | -----      |

#### B: DEKLARATË

